

## Newsletter 2012

Rellinghauser Str. 22  
45128 Essen

Tel.: + 49 (20 1) 75 99 85 28  
Fax: + 49 (20 1) 75 99 85 29  
E-Mail: info@i-de-al.org  
Web: www.i-de-al.org

## Retrospektivë!

### Duke skanuar vitin 2012!

Amtsgericht: Essen VR 5251  
Steuernr.: 112/5870/1294

Bankverbindung: Postbank  
Kontonr.: 999 44 64 35  
BLZ: 360 10 0 43

Präsidentin: Anduena Stephan  
Vertretung: Migen Begolli

Të dashur Anëtarë të **IDEAL**, të dashur miq,

Essen, am 8.01.2013

viti që shkoi ishte një vit i mbushur me aktivitete dhe ngjarje të shënuara. **IDEAL** me mbështetjen jo vetëm të anëtarëve të tij por edhe të gjithë dashamirësve të Shqipërisë, Kosovës dhe trevave shqiptare dha kontributin e tij modest, por të rëndësishëm në vendosjen e diasporës sonë në vëmendje të shtetit ku jetojmë dhe të shteteve tona amë.

Ky vit nisi me një event shumë të bukur: “**Ditën e dyerve të hapura**” dhe inagurimin e zyrave tona në **Rellinghauserstr. 22**, në **45128 Essen** dhe me festimin simbolik të **8 Marsit**. Në mbrëmjen tonë të parë të **bowling ne dhe fëmijët tanë** provuam „forcat“ dhe u bindëm se ditët tona simbolike duhet të vazhdojmë t’i festojmë së bashku.

Aktivitetet tona u pasuan nga takime shumë të rëndësishme midis bordit të **IDEAL** dhe përfaqësuesit të Zyrës për Integrim të qytetit të Essenit, **z. Andreas Bomheuer** dhe drejtorit të po këtij institucioni, **z. Günther Dercks** të cilët e mirëpritën angazhimin tonë për pozicionimin në mënyrë më aktive të diasporës shqiptare në tavolinën e kulturave të qytetit tonë.



Një ditë e vecantë për ne të gjithë ishte **1 Qershori**, ku në përgjigje të ftesës nga **IDEAL** publicisti i njohur **Z. Virgjil Kule** prezantoi ne Bibliotekën e Essenit **Bestseller-in** e tij më të fundit „**Gjergj Kastrioti Skënderbeu – Kryqtari i Fundit**“.

Në praninë e më shumë se **120** pjesëmarrësve gjermanë dhe mbarëshqiptarë, të nxënësve të shkollës shqipe të Essenit dhe të mësueses së tyre të palodhur **Znj. Vitori Përgjoka** si dhe të ambasadorit të Shqipërisë të akredituar në Berlin, Shkëlqesisë së tij **Z. Valter Ibrahim**, ky event u bë një gur tjetër i rëndësishëm në prezantimin e historisë dhe kulturës sonë.


Shumë simbolik dhe i vecantë nga natyra dhe rëndësia ishte edhe akti i dhurimit të **koleksionit të parë prej 25 librash në shqip dhe gjermanisht** të autorëve shqiptarë, për fëmijë dhe për të rritur ndaj Bibliotekës së Essenit. Në këtë link <http://www.stadtbibliothekessen.de> ju mund të kërkonti në faqet e bibliotekës së Essenit dhe në cdo filjal të qytetit këto libra dhe t'i shijoni ata së bashku me fëmijët tuaj. Në fund të këtij shkrimi ju do të gjeni **listën e plotë të librave** që gjenden në këtë bibliotekë, **Aneksi 1**.



Ky aktivitet u shoqërua me takime të tjera shumë të rëndësishme me partnerë të **IDEAL**, si ai me **Drejtorin e Initiativkreis Ruhr, Z. Jan-Peter Nissen** apo dhe bisedat me përfaqësues të **NRW International**, për të diskutuar dhe bashkërenduar aktivitete të përbashkëta të rëndësishme

Aktivitetet e **IDEAL** vijuan në muajin **Qershor** me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të tij në konferencën ekonomike shqiptaro-gjermane në Tiranë nga dt. 19 deri në dt. 20 Qershor ku morën pjesë përfaqësues të më shumë se **300 bizneseve në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni dhe Gjermani**. Bashkëpunimi i IDEAL me DAW dhe DIHA është një bashkëpunim i ngushtë që ka lindur që në ditët e para të krijimit të shoqatës sonë.

Edhe në muajt e verës **Korrik dhe Gusht IDEAL** u aktivizua në **dy projekte** të Organizatës Ndërkombëtare të Migracionit në kuadrin e projekteve të **kthimit virtual të diasporës në vendet amë** duke dërguar dy anëtarë të tij për të bërë një shkëmbim eksperience me Bashkinë e Tiranës (z. Gent Ishmaku) dhe Drejtorinë e Inspektimit dhe Shpëtimit të Minierave (Znj. Anduena Stephan).



Edhe me Shqipërinë, lidhjet dhe kontributi i **IDEAL** u forcuan më tej. Në **Shtator IDEAL** mori pjesë për herë të parë në panairin e **Ruhrdax** i cili synon binjakezimin e shoqatave jofitimpruprese me kompanite me të mëdha të Dax. **IDEAL** prezantoi shoqatën dhe objektivat e saj dhe inicioi bashkëpunimin e parë me **Labdoo** në fushën e informatikës. Në bashkëpunim me këtë shoqatë **IDEAL** i dhuroi **6 laptop** të ricikluar Shkollës 9 Vjecare Fan S. Noli në Tiranë <http://www.labdoo.org/content/albania-tirana-fan-s-noli-school-0>. Kjo shkollë e cila në programin e saj ka gjuhën gjermane si gjuhë të huaj dhe është një nga shkollat më të vjetra të Tiranës ka tani mundësi që sipas programit të saj të zhvillojë orë mësimi kompjuterike në gjuhën **shqipe, gjermane dhe angleze** duke integruar në lëndën mësimore lojrat e shkëlqyera didaktike për të gjitha nivelet e nxënësve të paraprogramuara në sistem.

Të shumta qenë aktivitetet që organizoi dhe mbështeti **IDEAL** dhe në muajin **Tetor** dhe **Nëndor**, sic ishte një debat shumë interesant që u zhvillua në sallat e leksioneve të Universitetit më të vjetër privat në Gjermani në **Witten** në bashkëpunim me katedrën e historisë dhe filologjisë së këtij universiteti me pjesëmarrjen e publicistit, politikanit dhe shkrimtarit shqiptar **Besnik Mustafaj** mbi temën: „**Roli i Shqiptarëve në Ballkanin e sotëm**“.



Më pas **IDEAL** dhe Organizata Ndërkombëtare e Migracionit në qytetet e **Gelsenkirchenit**, **Wuppertalit** dhe **Krefeldit** organizuan respektivisht më dt. **27 dhe 28 Tetor 2012** dy seminare shumë të rëndësishme me **diasporën shqiptare** të Shqipërisë, Kosovës dhe Maqedonisë të cilët patën mundësinë të diskutonin mbi iniciativat më të fundit të qeverisë së Kosovës me qëllim integrimin dhe mobilizimin e diasporës në forcimin e ekonomisë së saj.

Më 13 **Nëndor 2012** **IDEAL** mori pjesë në konferencën rajonale të **IOM** dhe **GIZ** mbi temën „**Diasporat e Ballkanit**“ ku znj. Anduena Stephan mbajti edhe një kumtesë mbi rëndësinë e shkëmbimit të eksperiencave në rajon dhe më gjerë.



Shumë e rëndësishme dhe me një simbolikë të vecantë ishte për **IDEAL** edhe ngjitja në skenë e **Znj. Migen Begolli Moisis**, anëtare dhe **zv/presidente e IDEAL** si një nga përfaqësueset e 100 historive të suksesit të diasporës në përvjetorin e 100-të të Pavarësisë në një nga eventet më të bukura të vitit në Tiranë më 23 **Nëndor 2012**. Urime Migen!

Në vazhdim **IDEAL** mori pjesë në aktivitetet shumë të bukura të organizuara nga **shkollat shqipe të Essenit, Krefeldit, Gelsenkirchenit, Düsseldorfit** me rastin e festës së pavarësisë për të kulminuar me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të saj më dt. **28 nëndor 2012** në **Berlin** edhe **ngritjen e flamurit shqiptar në kryeqytetin gjerman** në praninë e më shumë se 500 të ftuarve, midis tyre personalitet të larta të politikës gjermane sikurse ishte **Kryeparlamentari gjerman** Norbert Lambert apo të ftuar të tjerë.

Një vend të vecantë këtë vit jubilar zunë edhe takimet e **IDEAL** përgjatë **gjithë vitit** me shoqatat e tjera simotra dhe institucione shqiptare me qëllim njohjen reciproke dhe për të diskutuar mbi shkëmbimin e ideve, aktivitetet e ndryshme dhe koordinimin e tyre.

Kështu **IDEAL** zhvilloi takime me

- **Albanien Freunde e.v., Albanien Hilfe e.V,**
- **Deutsch Albanisch Wirtschaftsgesellschaft DAW e.V.,**
- **Albanische Kultur- und Sportvereinigung Gelsenkirchen,**
- **Ministrinë e Integritit të Shqipërisë, Ministrinë e Jashtme të Shqipërisë**
- **Institutin e Diasporës,**
- **Ministrinë e Punës dhe Drejtorinë e Integritit dhe Migracionit të Shqipërisë**

si edhe me

- **Ambasadorin e Republikës së Kosovës, Shkelqesinë e tij Z. Skender Xhakaliu dhe**
- **Ambasadorin e Republikës së Shqipërisë, Shkelqesinë e tij z. Valter Ibrahim.**

Jo më pak i rëndësishëm ka qenë mbështetja që **IDEAL** i ka bërë shkollave shqipe nëpërmjet takimeve me mësueset dhe mësuesit e tyre si me atë të shkollës shqipe të **Essenit dhe Krefeldit**, Znj. Vitori Përgjoka, **mësuesen e Gelsenkirchenit**, z. Etleva Perch, **mësuesen e Bergisch-Gladbach** znj. Mimoza Leka, **mësuesin e Düsseldorfit dhe mësuesen e Kölnit** znj. Etleva Mance. Edhe gjatë 2013 në bashkëpunim me **Ministrinë e Arsimit të Shqipërisë dhe Institutin e Diasporës IDEAL** do të vazhdojë të mbështesë shkollat shqipe me libra dhe materiale didaktike.

**IDEAL** e mbylli vitin me një mbrëmje të mrekullueshme festive në Essen –Werden me 31 **Dhjetor** 2012 dhe priti kështu së bashku me 44 anetare dhe miq të IDEAL ndërrimin e viteve. Mes urimeve, këngëve, valleve dhe humorit të shkëlqyer **IDEAL** u rrit edhe një vit më shumë.

**Viti i ri 2013** sapo ka hyrë dhe **IDEAL** dëshiron t'ju urojë të gjithëve:

**Gëzuar 2013!**

Një vit edhe më i bukur dhe më i mbarë ardhët.

Edhe në këtë vit **IDEAL** do të vazhdojë të organizojë **aktivitete kulturore, sociale dhe ekonomike** ku të gjithë shqiptarët e NRW si edhe të gjithë dashamirësit e kombit shqiptar të kenë mundësi të jenë së bashku.

Festes së **28 Nëntorit** këtë vit do t'i shtohen edhe aktivitete me rastin e **8 Marsit** dhe **1 Qershorit**.

Ejani me ne të tregojmë **vlerat tona, kulturën dhe vitalitetin tonë!**




**IDEAL** ju mirëpret si anëtarë apo si dashamirës të kombit dhe përparimit! Së bashku arrijmë më shumë.

Për më shumë informacione mbi ne na vizitoni në [www.i-de-al.org](http://www.i-de-al.org)

**Mirësevini!**

**IDEAL** -isht juaja



**Anduena Stephan**

**Presidente e Shoqates**



The poster features a dark background with vibrant, colorful light trails in green, yellow, and red. The IDEAL logo is prominently displayed in the center, with the 'i' in lowercase and 'DEAL' in uppercase. The text is in both German and Albanian, conveying New Year wishes to members and friends.

**Ein IDEAL-es Jahr 2013** **Gëzuar! Një Vit IDEAL ne 2013**

**IDEAL**  
Integrative Deutsch-Albanische Gesellschaft [www.i-de-al.org](http://www.i-de-al.org)

**Liebe Mitglieder, Kollegen und Freunde,  
wir wünschen allen IDEAL-e festliche Tage  
und ein glückliches Jahr 2013**

***Të nderuar Anëtarë, Kolegë dhe Miq,  
Ju urojmë ditë festive IDEAL-e dhe  
një 2013 plot fat e lumturi***

**INTEGRATION | KULTUR | WIRTSCHAFT | ZUSAMMENARBEIT**

## Aneksi 1

### Literture Shqiptare ne Biblioteken e Essen-it

#### Ne gjuhen shqipe

##### Libra per Femije

- Bushaka, Gaqo: Përrallat e shiut
- Bushaka, Gaqo: Çufoja dhe Bubi Kaçurrel
- Bushaka, Gaqo: Pushimet e Çufos
- Bushaka, Gaqo: Filmi i gjeneral Çufos
- Bushaka, Gaqo: Çufo president
- Grillo, Odhise K.: Lahuta e Malsisë

##### Romane

- Blushi, Ben: Otello, Arapi i Vlorës
- Blushi, Ben: Të jetosh në ishull
- Bulka, Nonda: Fabula në prozë
- Çajupi, Andon Zako: Vepra dramaturgjike
- De Rada, Jeronim: Këngët e Milosaos
- Zejno, Krenar: Këmba e të panjohurës

##### Publicistike

- Çabej, Eqrem: Shqiptarët midis Perëndimit dhe Lindjes
- Çabej, Eqrem: Diana dhe zana
- Cika-Kelmendi, Mimoza: Kosova si çështje europiane
- Cika-Kelmendi, Mimoza: Kadare ndryshe
- Ngjela, Spartak: Përkulja dhe rënia e tiranisë shqiptare
- Fevziu, Blendi: Enver Hoxha
- Kule, Virgjil: Gjergj Kastrioti Skënderbeu „Kryqtari i fundit“
- Pllumi, Zef: Saga e fëmijnisë
- Çabej, Eqrem: Hyrje në indoeuropianistikë

##### DVDs

- Virgjil Kule: Ionian romance [DVD]
- Virgjil Kule: Romance joniane [DVD]

## Libra te Autoreve Shqiptare ne Gjermanisht

### Romane und Publicistik

- Ahmeti, Mimoza: **Milchkuss**
- Ferra, Ilir: **Rauchschatten**
- Kadaré, Helena: **Eine Frau aus Tirana**
- Kongoli, Fatos: **Die albanische Braut**
- Kongoli, Fatos: **Hundehaut**
- Mustafaj, Besnik: **Kleine Saga aus dem Kerker**
- Ornela Vorpsi, Ornela: **Die Hand, die man nicht beißt**
- **Sowie die volle Kollektion der Bücher von Ismail Kadare**